



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

| | |
|----------------|--|
| Për : | Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës |
| Cc: | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë e Podujevës |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Ministre i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së |
| Nga: | Shkelqim Jakupi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Podujevës |
| Lloji i aktit: | Vendim |

Datë:
10/05/2017
020/717

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 01-034/01-0034565/17 për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në komunën e Podujevës për vitin 2017. |
| E miratuar më datë më datë: 03.05.2017 |
| E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.05.2017 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

| | |
|-------------|---|
| Za : | Agim Veliu, gradonačelnik opštine Podujevo Mehmet Gashi, predsedavajući Skupštine opštine Podujevo |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini Zakonsko odeljenje i monitorisanje opština/ MALS |
| Preko: | Ivan Todosijević, ministar MAPL-sa Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-u |
| Od: | Shkelqim Jakupi, v.d. rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Podujevo |
| Vrsta akta: | Odluka |

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br. 01-462/01-0034565/17 za usvajanje akcionog plana za transparentnost u opštini Podujevo za 2017. godinu |
| Usvojena dana, 03.05.2017. godine |
| Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 10.05.2017. godine |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u proceduralniom smislu u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



| | | | |
|---|--------------|---------|-------|
| HYRËSE-ULAZNA-INCOMING | | | |
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO | | | |
| QEVERIA E KOSOVËS / Vlada Kosova / GOVERNMENT OF KOSOVA | | | |
| Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | | | |
| Ministarsivo Lokalne Samouprave / Administracije | | | |
| Ministry of Local Government Administration | | | |
| Data | 10.05.2017 | | |
| Datum | 10.05.2017 | | |
| Date | | | |
| Nënsia organizatvive | Nr. i Lëndës | Shtojca | Sfera |
| -17- | 020-747 | | |



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 11.1 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2015 për Transparencë në Komuna, nenin 35 shkronja b dhe 37 pika 3 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr. 01/18-02 të datës 31 janar 2011, dhe nenit 15.2 shkronja d, të Statutit të Komunës, nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 03 maj 2017, miratoi këtë;

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E PODUJEVËS PËR VITIN 2017

Neni 1

Miratohet Plani i veprimit për transparencë në Komunën e Podujevës për vitin 2017.

Neni 2

Plani i veprimit sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-034/01-0034565/17
Podujevë,
03 maj 2017





HYRËSE-ULAZINA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
REPERA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministria e Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum
Date 10.05.2017

| Nënsia organizative | Nr. i Lëndës | Shtesa | Vlera |
|---------------------|--------------|--------|-------|
| -5 | 020-717 | | |



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

SKUPŠTINA

Shodno članova 11 i 12.2 slovo d zakona Lokalne samouprave br. 03/L-040, član 11.1 Administrativnog Uputstva br. 01/2015 za Transparentnost u opštinama, član 35 slovo b i 37 tačka 3 Pravilnika Opštine Podujevo za način, procedure i uslova učešća gradana u procesima odlučivanja br. 01/18-02 dana 31 januara 2011 i član 15.2 slovo d Statuta Opštine br. 01-1/298-10, Skupština opštine Podujevo na održanoj sednici dana 03 maj 2017 usvojila

ODLUKU

ZA USVAJANJE PLANA DELOVANJA ZA TRANSPARENTNOST U OPŠTINU PODUJEVO ZA 2017 GODINU

Član 1

Usvaja se plan delovanja za transparentnost u opštinu podujevo za 2017 godinu

Član 2

Plan delovanja po članu 1 je sastavni deo ove Odluke

Član 3

Odluka stupa na snagu posle ocene zakonitosti odnosno registracije u kanc. Protokola MALS-a i objave u opštinskom službenom web sajtu.

Br. 01-034/01-0034565/17
Podujevo
03 maj 2017





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË NË KOMUNËN E PODUJEVËS PËR VITIN 2017

**Podujevë
03 maj 2017**

| Objektivat e Planit të veprimtimit të transparencës | Aktivitetet e Planit të Transparencës | Njësia/ apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të Komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunale |
|---|---|--|--|---|
| <p>1</p> <p>Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve</p> | <p>Njoftimi për mbledhje të rregullta të Kuvendit të Komunës në: Ueb faqen zyrtare të Komunës; vendet më të frekuentuara brenda objektit të Komunës; në media të shkruara dhe elektronike; rrjete sociale</p> | <p>Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrtarit për komunikim me qytetarë, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik</p> | <p>Salla e Kuvendit të Komunës apo edhe sala të tjera të përshtatshme</p> | <p>Njoftimi për mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës është 7 ditë para mbajtjes.</p> |
| <p>2</p> <p>Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës</p> | <p>Njoftimi për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës bëhet në Ueb faqen zyrtare të Komunës; vendet më të frekuentuara brenda objektit të Komunës; media të shkruara dhe elektronike; rrjete sociale</p> | <p>Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrtarit për komunikim me qytetarë, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik</p> | <p>Salla e Kuvendit të Komunës apo edhe në sala të tjera të përshtatshme</p> | <p>Njoftimi për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës është 3 ditë para mbajtjes</p> |

| | | | | | |
|---|-------------------------|---|--|--|--|
| 3 | Konsultimet me publikun | Komuna organizon konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve Konsultimet për projektbuxhetin e Komunës Konsultimet për zhvillimin ekonomik të Komunës Konsultimet për planifikimin hapësinor Konsultimet për investime Konsultimet për të hyrat vetanake Konsultimet për çështje tjera me interes të përgjithshëm | Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë /zyrtarit për komunikim me qytetarë, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik Njoftimi bëhet: në ueb faqen zyrtare ; Në media të shkruara dhe elektronike; Vendet më të frekuentuara brenda objektit të Komunës; Rrjete sociale | Në sallën e Kuvendit të Komunës ose në objekte me hapësira të mjaftueshme brenda territorit të Komunës për pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut | Njoftimet për konsultimet me publikun publikohen dy javë para konsultimeve |
|---|-------------------------|---|--|--|--|

| | | | | | |
|---|---------------------|--|--|---------------|--|
| 4 | Takimet me publikun | <p>Komuna mban së paku dy takime për çështje të interesit të përgjithshëm në të cilat mund të marrin pjesë qytetarët dhe organizata me interes në Komunë</p> <p>Përveç dy takimeve publike Komuna duhet të shqyrtojë mundësitë për të mbajtur takime shtesë që lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Buxhetin e Komunës, - Zhvillimin ekonomik të Komunës, - Shfrytëzimin e pronës komunale - Planifikimin hapësinor - Për investime dhe të. Hyra vetanake si dhe çështje tjera interes të përgjithshëm | Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë /zyrtarit për komunikim me qytetarë, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik | Maj - Dhjetor | Njoftimet për konsultimet me publikun publikohen dy javë para konsultimeve |
|---|---------------------|--|--|---------------|--|

| | | | | | |
|---|--|--|--|--|--|
| 5 | <p>Takimet dhe intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ dhe media</p> | <p>Kryetari i Komunës në kuadër të kompetencave të tij realizon takime me qytetarë</p> <p>Takimet në formë debati me qytetarë</p> <p>Takime pyetje e përgjigje</p> <p>Intervista, konferenca për media etj.</p> <p>Kryetari i Komunës cakton një ditë brenda javës që në Zyrën e tij të ketë takime me qytetarë.</p> | <p>Përmes Zyrës për komunikim apo zyrtari përgjegjës për informim</p> | <p>Në Zyrë, salla të Komunës ose në objekte dhe hapësira të mjaftueshme brenda territorit të Komunës , për pjesëmarrje të gjerë të radio apo TV</p> <p>Njoftimi për takimet e Kryetarit me publikun publikohen në ueb faqen zyrtare të Komunës ;</p> <p>Në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës ;</p> <p>Në media të shkruara dhe elektronike</p> <p>Rrjetet sociale</p> | <p>Njoftimi për qytetarët lidhur me takimet dhe intervista me Kryetarin e Komunës bëhet së paku dy javë para mbajtjes së takimit apo intervistës.</p> |
| 6 | <p>E drejta e qasjes në dokumente publike</p> | <p>Kërkesat për qasje në dokumente publike trajtohen nga çdo institucion publik i Komunës që posedon dokumentin</p> | <p>Njësia/zyrtari për komunikim me qytetarë është dhe bën pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike të aprovuara nga organet e</p> | <p>Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrihen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim ose në formë elektronike</p> | <p>Komuna obligohet që brenda (7)ditëve nga dita e pranimin të kërkesës të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të jap përgjigje me shkrim për të arsyetuar</p> |

| | | | | |
|--|---|--|--|---|
| | <p>Institucioni publik ndihmon parashtruesin e kërkesës aq sa është e mundshme në bazë të arsyeshmërisë, të identifikojë dokumentin e kërkuar. Kërkesat për qasje në dokumente publike trajtohen sipas legjislacionit përkatës. Kërkesa për qasje në dokumentin publik shqyrtohet dhe trajtohet brenda afatit ligjor.</p> | <p>Komunës dhe i adreson në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike</p> | | <p>refuzimin e plotë apo të përsëritshëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën e tij.</p> <p>Afati për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike mund të vazhdohet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, në çoftë se dokumenti kërkohej jashtë organeve të Komunës, dhe nëse përmes një kërkesë kërkohej disa dokumente publike.</p> |
| <p>7</p> <p>Kërkesa për informim, iniciativat qytetare dhe peticioni</p> | <p>Subjektet fizike ose juridike kanë të drejtë të parashtrorinë kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciative qytetare dhe peticion për çështje që janë përgjegjëse organet e Komunës</p> <p>Partneritet qytetarë-komunë</p> | <p>Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari i Komunës ose njësia/zyrtari për komunikim me qytetarët jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15)ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit</p> | <p>Kërkesa për informim, iniciativa qytetare dhe peticioni parashtrohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim</p> | <p>Kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, siç është përcaktuar në nenin 70 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale</p> |

| | | | | | | |
|---|--|--|--|---|---|---|
| | Mbështetja e iniciativave për qytetarë | Investime në Interes të përgjithshëm ku participimi është bashkë me qytetarë Mbështetje OJQ-ve për realizimin e aktiviteteve në Interes të përgjithshëm Përfshirja e qytetarëve në komisione të ndryshme Informimi i qytetarëve me kohë lidhur me kërkesat e parashtruara | Zyrtari përgjegjës për informim përmes njësite që posedojnë dokumentacione | Të gjitha vendimet, rregulloret tjera të dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qashme për publikum pas vlerësimit të ligjshmërisë nga | Të gjitha aktet nënligjore dhe dokumentet tjera publike duhet të publikohen në ueb faqen zyrtare të Komunës Medie të shkruara dhe elektronike Në vende të frekuentuara brenda territorit të Komunës | Aktet nënligjore të komunës publikohen në faqen zyrtare 15 ditë pas regjistrimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ndërsa dokumentet tjera publike publikohen pas hyrjes në fuqi |
| 8 | Publikimi i akteve komunitare | | | | | |

| | | | | | | |
|----|--|--|--|---|---|--|
| 9 | <p>Freskimi i ueb faqes zyrtare të Komunës</p> | <p>Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal</p> | <p>Ueb faqja zyrtare e Komunës siç e përcakton Udhëzimi administrativ Nr. 01/2015</p> <p>Ueb faqja duhet të jetë kompatible me shfletuesit më të kërkuar në internet</p> <p>Ueb faqja duhet të jetë e lehtë për shfletim</p> <p>Arrija deri te informacionet në ueb faqe të jetë me sa më pak hapa-klikime</p> | <p>Obligohet njëjësia përgjegjëse për komunikim me publikun ose zyrtarët e ngarkuar me këtë detyrë që të ndërmarin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ</p> | <p>Apo në rrjete sociale</p> <p>Ueb faqja e Komunës duhet të ketë Hartën e Faqes –(Strukturën e faqes); Lidhja (linku) me portalin shtetëror dhe Lidhjen (linkun) me Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës</p> | <p>Mirëmbajtja e ueb faqes zyrtare duhet të jetë funksionale, ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ nr. 01/2015</p> |
| 10 | <p>Qasja e shërbimeve për qytetarë të transparentë dhe shpejtë</p> | <p>Certifikata e lindjes , Certifikata e vdekjes, Certifikata e shkurorëzimit, Certifikata të statusit martesor, Dëshmi për personin që është gjallë , Dëshmi për vdekjen e cila u shërben</p> | <p>Njëjësia përkatëse me zyrtarin e TI-së së bashku me zyrtarin përgjegjës</p> | <p>Të jenë formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve të publikuar në ueb faqen zyrtare, ku qytetari ta ketë qasjen e lehtë</p> | <p>Në ueb faqen zyrtare te linku i shërbimeve për qytetarë publikohen edhe procedura për shërbime dhe afate të caktuara për kryerjen e shërbimeve</p> | |

| | | | | |
|----|--|---|---|--|
| | <p>qytetarëve për trashëgimi, Vërtetimi që është mbajtes i familjes,</p> <p>Regjistrimi i lindjeve, Regjistrimi i vdekjeve, Regjistrimi i kurorëzimeve nga bota e jashtme për të gjitha Komunitatet e Kosovës Si dhe Certifikatat mbi bashkësitë familjare</p> | | | |
| 11 | <p>Prokurimi transparent</p> | <p>Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me zyrat e përgjegjës për komunikime</p> | <p>Njoftimet nga fusha e prokurimit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Komunitetit dhe në medie të shtruara dhe elektronike (Pas aplikimit të prokurimit elektronik)</p> | <p>Njoftimet dhe dokumentet tjera të prokurimit publikohen duke i respektuar afatet ligjore</p> |
| 12 | <p>Procedurat e përcaktuara për qytetarët</p> | <p>Përgjegjëse për publikimin e procedurave të shërbimit civil është Zyra e personelit së bashku me zyrat e komunikimit</p> | <p>Publikimi i të gjitha procedurave në shërbimin civil bëhen në ueb faqen zyrtare të Komunitetit, në objektin e Komunitetit, në</p> | <p>Publikimi dhe zbatimi i procedurave të shërbimit civil duke përfshirë afatet për shpalljen e konkursit, njoftimit të kandidatëve, vazhdimi i konkurseve</p> |

| | | | | |
|--|--|--|---|---|
| | <p>Njoftimi për anulimin e konkursit</p> <p>Rishpallja apo vazhdimi i konkursit</p> <p>Avancimet brenda institucionit</p> <p>Apikacionet për punësim</p> | | <p>medie të shkruara dhe elektronike</p> <p>Publikimi duhet të jetë edhe te institucioni përgjegjës për shërbimin civil</p> | <p>bëhet në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil</p> |
|--|--|--|---|---|

Podujevë,
03 maj 2017

